

KËRKIME GJUHËSORE

Rovena VATA

MITI I GJUHËS SI SHENJË IDENTIFIKIMI NË AUTORËT E LETËRSISË SHQIPE

Që nga Aristoteli e këndej ne e dimë se mjet për shprehjen letrare është gjuha. Mjeti nuk është arti, por realizimi formal i tij. Gjuha në esencë është mjet komunikimi dhe si të tillë e studion gjuhësia, të cilën e ka forcuar Sosyri. Gjuha, që nga rrënjët e saj, të cilat vështirë mund të hetohen, e deri më sot nuk ka arritur ta mënjanojë nga trupi i vet shumëkuptimësinë, motivimin e figurën. Prandaj kemi, në një rën anë gjuhën arbitrare, apo konvencionale, që është gjuha e komunikimit të zakonshëm, dhe gjuhën e motivueshme apo të pazakontë, që është gjuha e figurës.

Këtë dukuri shumë mirë e ka shpjeguar Roman Jakobsoni te një tekst me titull: *“Poli metaforik dhe metonimik i gjuhës”*, ku ka konstatuar se gjuha e letërsisë në fakt është shmangia nga komunikimi i zakonshëm. Kur kjo shmangie dominon, atëherë kemi të bëjmë me tekst të figurshëm që ne i themi letërsi.

Zherar Zheneti e barazonte shkrimtarin me shkrimtarin-kritik. Ata i kanë dy qëllime, që janë të përbashkëta për të dy: të shkruajnë dhe të heshtin¹.

Mitologjia si shumë e miteve ka shoqëruar njerëzimin deri në bashkëkohësi, qoftë duke u ruajtur në shtresat e jetës dhe të kulturës, qoftë duke buruar nga koha, pra si mitologji bashkëkohore. Prandaj, gjithnjë është e nevojshme që të veçohet miti dhe mitologjia e trashëguar në jetën dhe në kulturën e njerëzve, nga mitologjia që krijon jeta dhe kultura bashkëkohore.

Gjuha shqipe, që dallon shqiptarët nga pjesa tjetër e botës,-thotë Dozoningjante se duhej të jepte çelësin e prejardhjes së tyre dhe të zbulonte se prej nga rridhnin ata. Kjo gjuhë, mozaik i çuditshëm copash që ngjajnë të mbledhura nga çdo anë, nuk ofron në pamje të parë veçse një enigmë tjetër të çuditshme dhe të padeshifrueshme².

Miti jeton në letërsi edhe si temë e rigjetur, e rishkruar, e rirrefyer, madje si temë e vjetër e gjetur në jetën bashkëkohore, në raportet e përditshmërisë. Miti është një nga esencat e letërsisë, një frymë që e shoqëron çdo vepër letrare që synon të kapërcejë kohën e krijimit dhe të universalizohet, sepse vetë miti është strukturë universale.

Për thajse 100 vjet krijimtari kushtuar gjuhës shqipe, gjedhi modelor për *“mitopoeian gjuhë shqipe”*, shfaq të njëjtën paradigmë: adhurim-mallkim³, siç e ndeshim tek vargjet e poetëve Naim Frashërit (*“Gjuha jonë”*, *“Korça”*, *“Fjalët e Qiririt”*), Petro Nini Luarasi (*“Kundër mallkimit të gjuhës shqipe”*), At Gjergj

¹ Zherar Zhenet, *“Figura”*, Rilindja, Prishtinë, 1984, f. 48.

² Gaetano Petrota, *“Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare”*, Almera, Tiranë, 2008, f. 39.

³ Silvana Leka, *“Mitopoeia e adheut dhe e gjuhës shqipe”*, Poetika, nr. 19, Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike & Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Tiranë, 2011, f. 19.

ROVENA VATA

Fishta (“Gjuha shqype”), Ndre Mjeda (“Gjuha shqipe”), Hil Mosi (“Gjuhes shqype”), Ernest Koliqi (“Gjuhës shqipe”), Lasgush Poradeci (“Gjuha e zjarrtë”), Mitrush Kuteli (“Gjuhës shqipe”), Ismail Kadare (“Gjuha shqipe”), Xhevahir Spahiu (“Gjuha shqipe”).

Dy breza pas Gjok Buzukut vjen figura e dytë madhore e letërsisë së hershme shqiptaro-veriore. Pjetër Budi (1566-1622), i njohur në italisht si Pietro Budi, është autori i katër veprave fetare në gjuhën shqipe. Ai u lind në fshatin Guri i Bardhë në krahinën e Matit, në malet⁴ e Shqipërisë qendrore-veriore.

Gjuha e përdorur nga Budi në veprat e tij është një formë arkaike e gegërishtes që ruan shumë tipare fonetike interesante. Eqrem Çabej ka vënë në dukje se Budi është munduar të shkruajë në një farë gjuhe letrare dhe jo thjesht në dialektin e tij të lindjes, gjë që përsëri mund të merret si tregues i ekzistencës së një farë tradite letrare në Shqipërinë Veriore. Alfabeti i përdorur prej tij është i ngjashëm me atë të paraardhësit, Gjon Buzuku, ndonëse Budi nuk e përmend askund që të ketë dëgjuar ndonjëherë për Buzukun⁵.

Miti i gjuhës shqipe ka shënuar në të njëjtën kohë edhe mitin e origjinës, mitin e lashtësisë, mitin e autoktonisë, mitin e identitetit⁶.

Gjuha është e lidhur fort me kulturën e një populli që e flet, por ekzistojnë shumë kultura që gjuha e tyre nuk është më, shumë kultura kanë mbijetuar, edhe pse gjuha e tyre virtualisht është shuar; kulturat e tjera kanë mbijetuar, sepse kanë qenë pjesë e një tradite orale, e cila është mbajtur gjallë sidomos në komunitete të izoluar ose edhe për faktin se pjesëtarët e kanë mësuar gjuhën dominante, gjë që u ka mundësuar ta mbajnë gjallë edhe gjuhën e tyre⁷.

Letërsia quhet arti i fjalës, sepse pikërisht gjuha është “lënda” prej së cilës ndërtohet vepra letrare. Kështu theksohet njëkohësisht edhe pozita specifike e letërsisë midis arteve të tjera. Vërtet gjuha nuk është lëndë në atë kuptim siç është ngjyra e pikturës, apo tingujt lëndë e muzikës, gjuha nuk është “lëndë e parë”, por në vetvete është krijim shpirtëror fort i ndërlikuar, prandaj pa e kuptuar natyrën e gjuhës, nuk mund të kuptohet as natyra e letërsisë. Edhe raporti i letërsisë ndaj realitetit duhet të shqyrtohet brenda raportit të gjuhës ndaj shoqërisë; letërsia, përmes gjuhës, indirekt i detyrohet shoqërisë; dhe studimi i letërsisë si art gjithnjë parashtron një të kuptuar të caktuar të gjuhës⁸.

*“Gjuh’ që t’foli Skanderbegu,
dhe ndër t’par qe Naim Begu,
që me shkrim të pat lartësu.
Ty t’kan fol’ shum’ kapidana,
Burra t’rrebt si t’ishin zana’*

⁴ Po aty, f. 22.

⁵ Robert Elsie, “Letërsia shqipe”, Skanderbeg books, Tiranë, 2006, f. 26.

⁶ Shaban Sinani, “Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të”, Naimi, Tiranë, 2010, f. 481.

⁷ Nysret Krasniqi, “Teori dhe kritikë moderne”, Rozafa, Prishtinë, 2008, f. 446.

⁸ Milivoj Solar, “Hyrje në shkencën për letërsinë”, Rilindja, Prishtinë, 2003, f. 11.

*Gjuh' e rrebt, ti qofsh nderu!*⁹

Më i madhi përfaqësues i shkollës së jezuitëve, kultivues i madh i gjuhës e i simboleve,¹⁰ Ndre Mjeda shkroi një tekst teorik për letërsinë, më saktësisht për natyrën e poezisë. Teksti *Përmbi poezi përgjithësisht*¹¹ është tekst reflektiv i cili prek në traditën e teorisë së arteve, sidomos në teoritë estetike për natyrën e tij.

*“Oh, zbrit ndër ne, mbretnore
Shqype, edhe 'j herë, si zbrite
Kur përmbi ball' madhnore,
T'madhit Kastrioti i shndrite,
E u trand gjith' bota unji.
Prej vringllit t'shpatës s'tij”*¹².

Trashëgimia mitologjike e botës shqiptare vjen prej burimesh dhe kohërash të ndryshme: nga burimet antike të kulturave greko-romake; nga tradita arkeologjike: mitet dhe kultet parashqiptare; nga tradita e letërsisë gojore: eposi i kreshnikëve, baladat, besa, nderi, miku, përgjithësisht e drejta zakonore popullore; nga historia: miti i Gjergj Kastriotit; nga vetë letërsia: miti i rikthimit në atdheun e munguar; nga shkenca albanologjike¹³.

*“Vjen njer' i huej e ju rri n' votër,
me ju tupnu' me gru' e me motër;
e për sa pare që do t'fitoni,
besën e t'parëve t'gjith' e harroni,
baheni robt e nierit t'huej,*

*që nuk ka gjuhën, as gjakun tuej!”*¹⁴. Apelon këtu autori.

Northropp Fray në teorinë e tij të mitit synon të depërtojë e të zbulojë këtë formë arkaike të kulturës njerëzore dhe shfrytëzimin e saj në krijimtari. Sipas tij kemi tri organizime të miteve dhe simboleve arketipore në letërsi:

1. *“Mitin e zhvendosur i cili merret me zotër e demonë dhe merr formën e dy botëve të kundërta.*

2. *Tendencën e realizimit për ta vënë theksin në përmbajtje dhe në prezantim më parë sesa në formën e tregimit.*

⁹ Hil Mosi, “*Vepra Letrare*”, poezia “*Gjuha shqype*”, Naim Frashëri, Tiranë, 1986, f. 81.

¹⁰ Ernest Koliqi, “*Dy shkollat letrare*”, Shpresa, Prishtinë, 1998, f. 51.

¹¹ Ndre Mjeda, *Përmbi poezi përgjithësisht*, Shkëndija, viti I, nr 8-9, Tiranë, 1941. cituar sipas I. Rugovës, S. Hamiti, *Kritika letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 117-124. Shih edhe: Anton Nikë Berisha, “*Mbi këngët e Milosaut*”, në: Ndrë Miedia, *Ândrra e jetës* (botuar sipas origjinalit të Vjenës-1917), Shpresa, Prishtinë, 2001.

¹² Ndre Mjeda, “*Vepra letrare I*”, poezia “*Shqypes arbnore*”, Naim Frashëri, Tiranë, 1988, f. 158.

¹³ Naim Zoto, “*Antologji për gjuhën shqipe*”, (në 100-vjetorin e shtetit shqiptar), Naimi, Tiranë, 2012, f. 9.

¹⁴ Naim Zoto, “*Antologji për gjuhën shqipe*”, Pasko Vasa, poezia “*O moj Shqypni*”, Naimi, Tiranë, 2012, f. 32.

ROVENA VATA

3. *Tendencën e përgjithshme që e kemi quajtur romantike për të sugjeruar monstra të nënkuptuara mitike në një botë të shoqëruar ngushtë me përvojën njerëzore*¹⁵.

E ku shkruhenë në kartë

Fjalët' e gjuhësë zjarrtë? (Naim Frashëri, Fjalët e qiririt)

Miti konsiderohet vetëdija e shtrembëruar e njeriut, në një anë dhe gjuhë e një modeli të tërë të letërsisë, në anën tjetër. Struktura e vetëdijes mitike përcakton edhe strukturën e përjetimit të botës dhe bëhet, jo vetëm model i qëndrimit, por edhe i pranimit të realitetit. Në kushtet e vetëdijes mitike njeriu i mitizon të gjitha kategoritë antropologjike e historike¹⁶.

Dihet se gjuha është korpus rregullash dhe shprehish, të përbashkëta për të gjithë shkrimtarët e një epoke. Kjo do të thotë se gjuha është si një natyrë që kalon tërësisht nëpër të folurit e shkrimtarit, pa i dhënë megjithatë asnjë formë, as pa e ushqyer: ajo është si një rreth abstrakt të vërtetash, vetëm jashtë së cilës nis të kullojë dendësia e një verbi të vetmuar. Ajo përmbush të gjithë krijimtarinë letrare për afërsisht si qielli, dhe bashkimi i tyre që përvijojnë vatrën intime të njeriut¹⁷.

Sosyri thotë se "*Gjuha është gjithmonë trashëgimi*", dhe, për pasojë, në njëfarë mënyre e natyralizuar. Në të njëjtën mënyrë, Levi-Strosi saktëson se shenja gjuhësore është arbitrare *a priori*, por jo arbitrare *a posteriori*¹⁸.

Gjuha ideale e shkencës është "denotative" në kuptimin më të saktë të fjalës: ajo synon të arrijë një lidhje të drejtpërdrejtë midis shenjës dhe asaj që shënohet. Shenja është konvencionale, prandaj ajo mund të zëvendësohet nga shenja ekuivalente. Përveç kësaj, shenja është e qartë, transparente, pra, pa tërhequr vëmendjen ndaj vetvetes, ajo na shpie drejtpërdrejt tek ajo çka shënohet¹⁹.

Romantikët e quanin "*Gjuhë perëndie*". Kur Naimi vendosi të shkruajë në gjuhën shqipe amtare, shqipja që nuk kishte ende një alfabet të njësuar, letërsia e ardhur përmes saj nuk kishte lexues. Naimi e bëri shqipen të flasë shqip, në kuptimin burimor të kësaj fjale²⁰.

"Pa shihni ç'gjuh' e mirë!

Sa shije ka e hije,

ç'e bukur' edh' e lirë,

¹⁵ Northrop Frye, "*Anatomia e Kritikës*", Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 192.

*Shih Jean Chevalier & Alain Gheerbrant, "*Dictionnaire des symboles*", Robert Laffont / Jupiter, Paris, 1969, f. 348 kur shprehet se: "Demonët janë të përhapur pothuajse në të gjithë popujt në botë, ato janë mbeturina primitive të këtyre popujve, por që edhe sot në shumë prej tyre besohet se ekzistojnë dhe veprojnë".

¹⁶ Bajram Krasniqi, "*Kode të ligjërimit letrar*", Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 82.

¹⁷ Roland Bart, "*Aventura semiologjike*", Rilindja, Prishtinë, 1975, f. 31.

¹⁸ Po aty, f. 132.

¹⁹ Wellek Rene & Warren Ostin, "*Teoria e letërsisë*", Onufri, Tiranë, 2007, f. 20.

²⁰ Po aty, f. 278.

*si gjuhë perëndie*²¹.

“*Bagëti e bujqësi*”, Bukuresht 1886, është një poemë baritore me 450 vargje që të kujton Virgjilin, me një mori panoramash nga atdheu i tij malor²².

*“Besën e t’parëve t’gjith e harroni,
baheni robt e njerit t’huej,
qi nuk ka gjuhën as gjakun tuej”*²³.

Gjuha shqipe (lingua albaneseca) përmendet qartë për herë të parë në vitin 1285, jashtë tokës shqiptare në Raguzë. Shembuj fjalësh për herë të parë mbledhi Ritter Arnold von Harf prej krahinës Julich të Rajnës së Poshtme, kur ai 1496, duke kaluar nëpër Durrës po shkonte në Jeruzalem për udhëtim të shenjtë. Kjo gjuhë është një degë e pavarur e trupit indoevropian. Për një kohë të gjatë nuk ishte e njohur si e tillë. Meritat më të mëdha për caktimin e saj në qarkun e gjuhëve indoevropiane i përkasin filologut të famshëm Gustav Majer²⁴.

Naim Frashëri është poeti që nismoi një shekull reformash shpirtërore dhe artistike në jetën e shqiptarëve, një zë me timbrin dhe forcën e një të riu dhe me pjekurinë e një të moçmi, zësjellësi i disa të vërtetave dhe disa projekteve ëndërore, që asnjë mendje, sado e guximshme të ishte, nuk do t’iu jepet dot jetë²⁵.

“*Gjuha*”, pra, na ngjall përfytyrimin e pavetëdijshëm mbi shtrirjen e ekzistencës tonë historike. Gjuha është kodi plus historia e tij²⁶.

Çdo fjalë ose njësi frazeologjike që përdorin njerëzit i ka rrënjët në veprimtarinë e brezave paraardhës ose bashkëkohës.

Poeti ynë kombëtar projektoi gjuhën dhe gjeografinë shpirtërore të shqiptarëve, ndërtoi një të tashme, duke sunduar në të shkuarën dhe hartoi vizionin tejet të qartë për të ardhmen. Naim Frashëri është krijuesi i letërsisë artistike në Shqipëri. Kjo s’do të thotë se përpara tij nuk ekzistojnë përpjekje në letërsinë shqipe. Qysh herët, Bogdani, e më pas Vaso Pasha, Kristoforidhi me “*Gjahun e Malësorëve*”, do të jepnin dëshmi të një arti të thellë, por me veprën e Naim Frashërit mund të flasim për një personalitet të plotë në letrat shqipe, më kompleksi deri më atëherë, hartuesi i një misticizmi oriental në poezinë shqipe²⁷. Naimi vendos prapashtesëzën -zë si pjesë përkëdhelëse ndaj gjuhës si edhe detyrën që kishin rilindasit tanë në atë kohë që jetuan.

*“Pa shihni ç’gjuh’ e mirë!
Sa shije ka e hije,
ç’e bukur’ edh’ e lirë,*

²¹Naim Frashëri, “*Lulët e Verësë*”, poezia “*Gjuha jonë*”, Naim Frashëri, Tiranë, 1890, f. 46.

²²Robert Elsie, “*Letërsia shqipe*”, Skanderbeg books, Tiranë, 2006, f. 74.

²³Naim Zoto, “*Antologji për gjuhën shqipe*”, Pasko Vasa, poezia “*O moj Shqypni*”, Pashko Vasa, poezia “*O moj Shqipni*”, Naimi, Tiranë, 2012, f. 88.

²⁴Milan Shuflaj, “*Serbët dhe Shqiptarët*”, Bargjini, Kumi, Tiranë, 2002, f. 104.

²⁵Luan Topçiu, “*Tradita moderne në letrat shqipe*”, Zenit Art, Tiranë, 2010, f. 45.

²⁶Jurij Llotman, “*Kultura dhe bumi*”, përktheu nga origjinali Agron Tufa, Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit & Aleph, Tiranë, 2004, f. 21-22.

²⁷Luan Topçiu, “*Tradita moderne në letrat shqipe*”, Zenit Art, Tiranë, 2010, f. 45.

ROVENA VATA

*si gjuhë perëndie*²⁸.

Çfarë ndodh kur një ndërgjegje njerëzore e integruar në një kulturë (në kulturën e vet), ballafaqohet me një vepër, shprehje a pjesë e një kulture tjetër? E thënë ndryshe, takimi i provokuar ose jo me të huajin, me atë që nuk flet të njëjtën gjuhë, që nuk ka të njëjtën kulturë, që është, (deri sa s'jam përpjekur ta marr vesh) një "barbarus", gjuha e të cilit mbetet e pakapshme për mua. "Takimi me tjetrin është në zemër të aksionit komparativist dhe, mund të thuhet, se ai mjafton për ta legjitimuar"²⁹.

*"E njat tokë që je tuj gëzue
E ke xanë tash sa mij vjet.
Shqyptaria që mbet mbëlue
Sot nën dhé, edhe shqyp flet"*³⁰.

Letërsia si fushë krijuese prodhon mitet e veta, mitet që burojnë nga vetë ajo. Mitet letrare janë figura e rrëfime të përsëritura, që i krijon vetë letërsia. Përsëritja i bën të njohura, të identifikuar, madje përfaqësuese, ashtu siç ndodh me mitet e lashta. Mitin e gjejmë në letërsi të përfaqësuar nga heronjtë e mëdhenj mitik, por, që ka shekuj që janë bërë dhe heronj letrar.

Letërsia nuk është armiqësore ndaj mitit, siç na ka rënë të lexojmë në studime moderne për raportet e letërsisë me mitin, është e kundërta, ajo është mjaft miqësore, sepse edhe kur e transformon mitin, edhe kur e bën temë letrare, ajo e ruan atë, e mban në trup dhe riaktivizon marrëdhënien me mitin, e riqarkullon atë, si një frymë të vjetër në një trup të ri. Kjo bën që miti të jetojë përherë në letërsi, që të jetojnë së bashku, madje të përcaktojnë natyrën e njëri-tjetrit në shkallë të ndjeshme.

Mitet herë vijnë si rrëfim (narracion), apo histori mbi të shkuarën dhe herë si një farë mjeti që do ta shpjegonte të tashmen, madje edhe të ardhmen e njerëzimit. Mitet janë bërë për të nxitur imagjinatën, shkruan Kamy tek eseja e njohur "Miti i Sizifit"³¹.

Miti fillestar ishte një botë. Një botë, d.m.th, një sistem, që ka një logjikë, që ka disa rregulla ndërtimi, që ka dhe të vërtetën e tij³².

Miti në letërsi është një bashkësi elementesh të lidhur, që kanë kuptimin e një përvoje njerëzore. Miti është një konfiguracion simbolik³³.

Natyrisht, popujt të ndryshëm krijojnë mite të ndryshme, ashtu sikurse popujt të ndryshëm shohin ëndrra të ndryshme. Po, pavarësisht nga këto

²⁸ Naim Frashëri, "Lulet e Verësë", poezia: "Gjuha jonë", Naim Frashëri, Tiranë, 1890, f. 46.

²⁹ Yves Chevrel, "La littérature comparée", PUF, Paris 1997, f. 34.

³⁰ Ndre Mjeda, "Vepra letrare I", poezia "Gjuha shqype", Naim Frashëri, Tiranë, 1988, f. 132.

³¹ Albert Kamy, "Miti i Sizifit", Fan Noli, Tiranë, 1996, f. 27.

³² Luan Topçiu, "Tradita moderne në letrat shqipe", Zenit Art, Tiranë, 2010, f. 182.

³³ Yves Chevrel, "La littérature comparée", PUF, Paris 1997, f. 79.

ndryshime, mitet dhe ëndrrat kanë një element të përbashkët, janë “shkruar” që të gjithë në të njëjtën gjuhë, në “*gjuhën e simboleve*”³⁴.

Të studiosh mitet do të thotë të hulumtosh mbi mënyrën si e paraqesin njerëzit veten e tyre dhe marrëdhëniet me botën ku rrojnë. Nuk mund të zërthehet dhe të analizohet një mit pa bërë kërkime mbi funksionin që ai kryen në shoqërinë, në të cilën është shfaqur³⁵.

Në teorinë e ndryshme për mitin gjejmë pikëpamje si ajo e Segalit se: “Miti nuk është si letërsia, por duhet studiuar si letërsi më tepër se historia, sociologjia, ose diçka tjetër jo letrare”³⁶.

Pier Brunel konstaton ambiguitetin e termave të mitit, rrënjën e përbashkët të tyre dhe identifikimet e tyre në kërkimet letrare. Për të shmangur këtë problem, ai propozon përkufizimin e mitit duke u nisur nga funksioni që ka ai:

- 1- *Miti rrëfen*, ky është funksioni i tij i parë.
- 2- *Miti shpjegon*, ky është funksioni i tij i dytë.
- 3- *Mit shpërfaq (zbulon)*, ky është funksioni i tij i tretë.
- 4- *Miti nuk ka autor*³⁷.

Letërsia ballkanike, është e veshur me petkat e mitit, merr frymë, zhvillohet përmes mekanizmave të mitit dhe qenësisht mbetet e gjallë duke u shqyer pa ndërprerje nga teknikat e tij, miti mbetet një statut ontologjik i njeriut ballkanik³⁸.

Miti dhe letërsia bashkëjetojnë me njëra-tjetrën në këto treva. Miti bën pjesë në një realitet të përjetshëm që mbart të vërtetat e përjetshme, që mbart kumte që luajnë një rol shumë të rëndësishëm në jetën e qenies ballkanike, që sjell mekanizmat e krijimit të tij për të shpjeguar ngjarjet e sotme.

Filip Shiroka pa u largue nga karakteristika kryesore të artit të tij si poet i qytetit të Shkodrës, na jep, në të njëjtën kohë edhe një poezi luftarake, me ndjenjë të thellë atdhedashurinë; një vjershë, që e ban me u dallue si kangatar i luftave për liri të popullit shqiptar³⁹.

*“Njesh’ armët gega i maleve;
Per soj m’a ké trimnine,
Me Tosken e guxueshëm
Lidh besen e vllazninë:
Gjith kah kù shqyp po flasin
T’tânat po u bertasin:
Nen t’huejin s’duem me mbetë!”*⁴⁰.

³⁴ Erich Fromm, “*Gjuha e harruar*”, Dituria, Tiranë, 1998, f. 9.

³⁵ Po aty, f. 84.

³⁶ Floresha Dado, “*Miti, simboli, realiteti në letërsinë tonë moderne*”, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2006, f. 89.

³⁷ Sabri Hamiti, “*Tematologjia*”, ASHAK, Botime të veçanta LXVII, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, libri 28, Prishtinë, 2005, f. 16.

³⁸ Luan Topçiu, “*Tradita moderne në letrat shqipe*”, Zenit Art, Tiranë, 2010, f. 208.

³⁹ Filip Shiroka, “*Zâni i zëmërës*”, Naim Frashëri, Tiranë, 1958, f. 25.

⁴⁰ Filip Shiroka, “*Zâni i zëmërës*”, Naim Frashëri, Tiranë, 1958, f. 62.

ROVENA VATA

Roland Barthes kur flet për mitin thotë: "...do të ishte plotësisht e gënjeshtërt përpjekja për të vendosur një diskriminim thelbësor midis objekteve mitike; sepse miti është shqiptim, gjithçka që i takon fushës së ligjërimit mund të jetë mit, miti realizon vetveten si letërsi"⁴¹.

Mundësia që miti të njihet përmes identifikimit të tij me objektin historik ose përmes krahasimeve me mitet e tjera, është refuzuar fuqishëm nga studiues të ndryshëm, ndër të cilët mund të përmendim edhe Ernest Cassireri ku në veprën e tij "*Filozofia e formave simbolike*", është shprehur që "*miti është formë e mendimit*"⁴².

*"Ke me pamë arena t'largta
Male t'reja e detna t'rij,
n'gjuhën tande tu' u përfalë,
dallëndyshe shtegëtare"*⁴³.

Dy mënyrat më të vjetra të këtyre formave simbolike për Cassirerin janë gjuha dhe miti. Ato shfaqen në kohë përtejhistorike, në lashtësi dhe forma mitike del prej formës gjuhësore e pastaj ato ndërthuren dhe gjuha gjithashtu, zhvillohet në mbështetje të mitit. Miti më kohë ka ndërtuar me anë të gjuhës idetë e veta figurative mbi bazë të një përvoje magjike në të cilën ka funksionuar gjithmonë, ashtu sikur edhe gjuha. Ai gjithashtu, përgjatë historisë i ka pasuruar format e tjera, si formën religjioze ashtu edhe formën artistike.

*"Epika fishtjane mos t'ishite shkrue me gjuhën e fortë të maleve, nuk e dij si do të kishte kumbue ndër veshët tanë, nuk e dij ku kishte vojtë ajo madhni luftarake që e ka veshun...sa për epikën, Fishta i ka vu vulën dhe ka krijue, posë tjerash, edhe gjuhën letrare-epike"*⁴⁴.

Në lirikën "*Gjuha shqype*" Fishta, për të treguar mprehtësitë e gjuhës shqipe në shprehjen e mendimeve dhe ndjenjave të ndryshme, të bën të ndjesh se si harpa e tij kumbon ëmbël, joshëse, e pëlqyeshme. I mërguari, që mbi një barkë nisat për vende të panjohura, duke braktisur me shpirtin e sfilatur nga dhimbja atdheun e tij për të shkuar në përballje të fatit të verbër në tokë të huaj, i drejton lamtumirën e tij të ngashëryer të tokës së lindjes, dhe me zor e ankth shkëputet nga gjërat më të shtrenjta me dyshimin sfilites për të ardhmen, duke menduar se do të kalojë ndoshta gjithë jetën e tij mes njerëzish me gjuhë, zakone, besim të ndryshëm: "*Lamtumirë vendet e mija të dashura që pak nga pak zhdukeni prej syve të mi. Deti zhurmëron, stuhia tërbon, barka përplasat me dallgët. Lamtumirë, o tokë e bekuar, lamtumirë për gjithmonë!*"⁴⁵.

*"Dua shumë fjalë t'u them,
Po trembem mos i bëni ujem.
E ku shkruhenë në kartë*

⁴¹ Roland Barthes, "*Mythology*", Paris, 1972.

⁴² Ernest Cassier, "*Phylososphy of symbolik forms*", 1925.

⁴³ Filip Shiroka, "*Zani i zëmres*", Naim Frashëri, Tiranë, 1958, f. 78.

⁴⁴ Injac Zamputi, "*Fishta, koha, njeriu, vepra*", Pasqyra, Tiranë, 1993, f. 18.

⁴⁵ Gaetano Petrota, "*Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare*", Almera, Tiranë, 2008, f. 334.

*Fjalët e gjuhësë zjarrtë?*⁴⁶.

Të gjitha kulturat kanë një gjuhë të folur, por disa prej tyre nuk kanë pasur sistem të shkruari. Gjuha është sistemi më i rëndësishëm i simboleve nëpërmjet të cilit transmetohet kultura nga një brez në tjetrin për këtë arsye gjuha është konsideruar si trashëgimi kulturore në formë të koduar.

Çdo fjalë ose njësi frazeologjike që përdorin njerëzit i ka rrënjët në veprimtarinë e brezave paraardhës ose bashkëkohës. Gjuha e shkruar ka funksione sociale të veçanta në krahasim me gjuhën e folur. Shkrimi është kusht i domosdoshëm i ekzistencës dhe funksionimit të institucioneve sociale.

*Kur të këndoj me gojë, kur të kuptoj në kartë
Posi një kraharuar ti dhemb, o Gjuhë-e zjarrtë,
Posi kullim' i gjakut që rreh në zemër time.
(Lasgush Poradeci, Gjuha e zjarrtë)*

Kadare ka shkruar që Gjuha shqipe është monumenti më i madh që ka krijuar populli shqiptar ndër shekuj. Gjuha shqipe përfundon Kadare është monumenti më i madh i kulturës shqiptare.

*“Kjo gjuhë martire,
lehonë e përjetshme,
që lindi mes dhembjesh
art të pavdekshëm”⁴⁷.*

Letërsia ndryshon dhe e intensifikon gjuhën e së përditshmes dhe devijon sistematikisht prej saj⁴⁸.

*“Në këtë gjuhë edhë njai Leka,
qi 'i rruzllim mbretin s'i a xuni,
qi kah bijte ai, shkelte deka,
shekllit mbarë ligjë t'randë i vuni;
në këtë gjuhë edhë Kastriota
u pat folë njatyne ushtrive,
qi sa t' ndrisë e diellit rrota,
kanë me kë në ndera e trimnive”⁴⁹.*

Letërsinë mund ta përkufizojmë si një mënyrë specifike e përdorimit të gjuhës. Sipas kësaj pikëpamje, letërsia kthehet në një mënyrë të shkruari, e cila, sipas fjalëve të kritikut rus Roman Jakobson, përbën një “*dhunë të organizuar që ushtrohet ndaj gjuhës së zakonshme*”.

Miti i gjuhës shqipe është miti më jetëgjatë në historinë e letërsisë kombëtare. Shqipja që flasim është kryeshenja e identitetit kombëtar shqiptar.

BIBLIOGRAFI

BARTHES, Roland, “*Aventura semiologjike*”, Rilindja, Prishtinë, 1975.

⁴⁶ Naim Frashëri, “*Fjalët e Qiririt*”, Vjersha për mësonjëtoret e para, Naim Frashëri, Tiranë, 1886, f. 41.

⁴⁷ Ismail Kadare, “*Vëllim me poezi*”, poezia “*Gjuha shqipe*”, Naim Frashëri, Tiranë, 1979, f. 276.

⁴⁸ Terry Eagleton, “*Hyrje në teorinë e letërsisë*”, “*Camaj-Pipa*”, Shkodër 2005, f. 10.

⁴⁹ Gjergj Fishta, “*Mrizi i zânave*”, At Gjergj Fishta, Shkodër, 1941, f. 7.

ROVENA VATA

- BARTHES, Roland, "Mythology", Paris, 1972.
- CASSIER, Ernest, "Phylososphy of symbolik forms", 1925.
- CHEVREL, Yves, "La littérature comparée", PUF, Paris 1997.
- DADO, Floresha, "Miti, simboli, realiteti në letërsinë tonë moderne", Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2006.
- EAGLETON, Terry, "Hyrje në teorinë e letërsisë", "Camaj-Pipa", Shkodër 2005.
- ELSIE, Robert, "Letërsia shqipe", Skanderbeg books, Tiranë, 2006.
- FISHTA, Gjergj, "Mrizi i zânave", At Gjergj Fishta, Shkodër, 1941.
- FRASHËRI, Naim, "Lulët e Verësë", Naim Frashëri, Tiranë, 1890.
- FRASHËRI, Naim, Fjalët e Qiririt, (Vjersha për mësonjëtoret e para, 1886).
- FROMM, Erich, "Gjuha e harruar", Dituria, Tiranë, 1998
- FRYE, Northrop, "Anatomia e Kritikës", Rilindja, Prishtinë, 1990.
- JEAN, Chevalier & ALAIN, Gheerbrant, "Dictionnarire des symbols", Robert Laffont / Jupiter, Paris, 1969.
- KADARE, Ismail, "Vëllim me poezi", Naim Frashëri, Tiranë, 1979.
- KAMY, Albert, "Miti i Sizifit", Fan Noli, Tiranë, 1996.
- KOLIQI, Ernest, "Dy shkollat letrare", Shpresa, Prishtinë, 1998.
- KRASNIQI, Bajram, "Kode të ligjërimet letrar", Rilindja, Prishtinë, 1988.
- KRASNIQI, Nysret, "Teori dhe kritikë moderne", Rozafa, Prishtinë, 2008.
- LEKA, Silvana, "Mitopoeia e atdheut dhe e gjuhës shqipe", Poetika, nr. 19, Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike & Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Tiranë, 2011.
- LLOTMAN, Jurij, "Kultura dhe bumi", përktheu nga origjinali Agron Tufa, Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit & Aleph, Tiranë, 2004.
- MJEDA, Ndre, "Vepra letrare I", Naim Frashëri, Tiranë, 1988.
- MOSI, Hil, "Vepra Letrare", Naim Frashëri, Tiranë, 1986.
- PETROTA, Gaetano, "Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare", Almera, Tiranë, 2008.
- SABRI, Hamiti, "Tematologjia", ASHAK, Botime të veçanta LXVII, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, libri 28, Prishtinë, 2005.
- SHIROKA, Filip, "Zâni i zëmres", Naim Frashëri, Tiranë, 1958.
- SHUFLAJ, Milan, "Serbët dhe Shqiptarët", Bargjini, Kumi, Tiranë, 2002.
- SINANI, Shaban, "Midis dy Rilindjesh", Naimi, Tiranë, 2010.
- SINANI, Shaban, "Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të", Naimi, Tiranë, 2010.
- SOLAR, Milivoj, "Hyrje në shkencën për letërsinë", Rilindja, Prishtinë, 2003.
- TOPÇIU, Luan, "Tradita moderne në letrat shqipe", Zenit Art, Tiranë, 2010.
- WELLEK, Rene & WARREN, Ostin, "Teoria e letërsisë", Onufri, Tiranë, 2007.
- ZAMPUTI, Injac, "Fishta, koha, njeriu, vepra", Pasqyra, Tiranë, 1993.
- ZHENET, Zherar, "Figura", Rilindja, Prishtinë, 1984.
- ZOTO, Naim, "Antologji për gjuhën shqipe", (në 100-vjetorin e shtetit shqiptar), Naimi, Tiranë, 2012.